


## Regjistrat e Biznesit në Shqipëri

Regjistrat e Biznesit përmbajnë të dhëna të detajuara për njësitë ligjore, ndërmarrjet dhe njësitë lokale që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Regjistrat e Biznesit janë bazë për hartimin e statistikave të nevojshme për dhënien e treguesve afatshkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike.

226.778 është numri i *njësive ligjore* aktive në fund të vitit 2023. 96.440 janë *fermerë* të pajisur me Numër Identifikimi të Personit të Tatuashëm NIPT.

Në fund të vitit 2023 numërohen 130.338 *ndërmarrje*, krahasuar me 125,222 në vitin 2022.

13.636 ndërmarrje aktive janë regjistruar gjatë vitit 2023, nga 15.700 të regjistruar gjatë vitit 2022.



Ekonomia shqiptare është e fokusuar kryesisht në aktivitetin tregtar dhe shërbime të tjera. Ndërmarrjet me aktivitet tregtar numërojnë 25,6% ndaj totalit të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2023. Aktiviteti tregtar realizon edhe xhiron vjetore më të madhe në ekonomi, me 40,8%.

## Edukimi Statistikor

---

**Ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përfaqësojnë 1,6% të totalit të ndërmarrjeve, punësojnë 50,0% të të punësuarve gjithsej, dhe realizojnë 45,3% të totalit vjetor të xhiros.**

Rreth 85,9% e ndërmarrjeve janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar dhe kontributi i tyre llogaritet në 22,6% në punësim dhe 20,2% në realizimin e xhiros vjetore.

	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
	1-4	5-9	10-49	50+
Gjithsej ndërmarrje aktive sipas madhësisë	111.938	9.035	7.318	2.047
Ndërmarrjet aktive drejtuar nga gratë	36.248	2.205	1.668	484

Në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Vlorë janë përqendruar pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, ndërsa në bashkinë Pustec shënohet numri më i ulët. Numri më i madh i ndërmarrjeve shënohet në qarkun e Tiranës me 61.602 ndërmarrje, ndërsa numri më i vogël në qarkun e Kukësit me 1.408 ndërmarrje

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 5,3% të ndërmarrjeve gjithsej dhe punësojnë 12,8% të të punësuarve gjithsej.


Ndërmarrjet nga vendet Bashkimit Evropian përfaqësojnë 63,1% të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta. Pronarët apo bashkëpronarët me origjinë italiane dhe greke përfaqësojnë 48,4% të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej.

Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqendruar kryesisht në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, përkatësisht me 65,6%, 10,8% dhe 4,4%.

### Gratë menaxhojnë/zotërojnë 31,2% të ndërmarrjeve gjithsej.

Aktivitetet “Tregtia” dhe “Shërbime të tjera” shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave në vendimmarrje, respektivisht me 33,9% dhe 40,5%. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht ndërmarrje me 1- 4 të punësuar.

Gratë zënë 47,0% të të punësuarve gjithsej dhe sektori me përfaqësimin më të ulët të tyre është sektori i ndërtimit me 17,1%.



Për nga ndarja rajonale, rajoni më i zhvilluar është rajoni qendër ku përfshihen qarqet Tiranë dhe Elbasan, ku janë përqendruar 53,2% e ndërmarrjeve. Të punësuarit në këtë rajon zënë 58,9% të të punësuarve gjithsej. Ndërmarrjet e regjistruara gjatë këtij viti janë përqendruar gjithashtu në rajonin qendër përkatësisht me 59,5%.

Ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetin në më shumë se një vendndodhje janë gjithsej 1.627 ndërmarrje të cilat përfaqësojnë vetëm 1,2% të ndërmarrjeve gjithsej dhe numri i të punësuarve në to është 23,7% e numrit të të punësuarve gjithsej. Njësitë lokale janë përqendruar kryesisht në qarqet Tiranë, Durrës me 56,0% të numrit të përgjithshëm të njësive lokale aktive

Fermerët të cilët shesin produktet e tyre po regjistrohen në zyrat rajonale tatimore duke u pajisur me Numër Identifikimi të Personit të Tatuashëm, (NIPT). Në këtë moment, fermerët zotërojnë personalitet juridik, e si të tillë janë objekt i regjistrave të biznesit që INSTAT mirëmban dhe përditëson. Numri i fermerëve të pajisur me NIPT në fund të vitit 2023 është 96.440 krahasuar me 84.369 fermerë në fund të vitit 2022.

Figura 1 Shpërndarja e njësive ligjore aktive sipas qarqeve

